



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 592/prot.,  
2

Tiranë, më 26.02.2019

**VENDIM**

Nr. 17, datë 26.02.2019

**MBI**

**KËRKESËN PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË KRYERJES SË AUDITIMIT ME OBJEKT  
“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE NË SISTEMIN E PROKURIMEVE NË REKTORAT”**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të pikës 17 të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017 “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, pasi shqyrtoi shkresën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm nr. 303/12 prot., datë 20.02.201 “Shtyrje e afateve të kryerjes së auditimit me objekt Sistemi i Prokurimeve”, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën për shtyrjen e afateve me 10 (dhjetë) ditë pune, të kryerjes së auditimit me objekt “Auditim përputhshmërie në sistemin e prokurimeve në Rektorat”, sipas propozimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
2. Efektet e llogaritjes së pikës 1, fillojnë nga dita që Njësia e Auditimit të Brendshëm merr dijeni për vendimin.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Njësia e Auditimit të Brendshëm të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

**KRYETARI**

**Adriana BERBËRI**

